



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Nr. 164, 167 Regj.
Nr. 60 Prot.

Tiranë më 22.02.2022

Lënda: Njoftim për kryerjen e veprimit ligjor, sipas urdhërimeve të përbaruesit gjyqësor me shkresën Nr. 164, 167 Regj. Nr. 1804 Prot. datë 26.10.2021 "Urdhër për vënien e sekuestros konservative".

Drejtuar Znj. Pranvera FAGU (BEHUSHI)
Drejtores e Përgjithshme e Qendrës Kombëtare të Biznesit

Për dijëni: "Raiffeisen Bank" sh.a.

E nderuar Znj. FAGU

Unë Natasha Laska, në cilësinë e Përbaruesit Gjyqësor, pranë "Zyrës së Përbarimit Privat Tirana Bailiff's" sh.p.k., në referim të Vendimit për Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 2847 Akti datë 06.05.2021 dhe Vendimit Mbi lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit nr. 7602 datë 19.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këto Urdhra, duke regjistruar në dosjet përbarimore Nr. 164, 167 Regj. kërkesën e kreditorit, lidhur me Titujt Ekzekutivë, Kontratë Kredie me Kufi Nr. 576 Rep., Nr. 210 Kol. datë 22.05.2018, e ndryshuar dhe Kontratë Kredie bankare Nr. 575 Rep., Nr. 209/2 Kol. datë 22.05.2018, me palë dhe objekt:

Kreditor: "Raiffeisen Bank" sh.a.;
Debitor: Shoqëria "New Pellet" sh.p.k. me NIPT L77422401C;
Debitor; Barrëdhënësit: Shoqëria "Lubima" sh.p.k. me NIPT K96419401J;
Dorëzanës: Shkëlqim Nexhat Keshi i dtl 25.07.1974
Dorëzanës: Luan Bilal Manjani i dtl 08.05.1959;
Hipotekues: Zare Bilal Keshi e dtl 28.05.1949,
Objekt: Kthim Shume (kredi bankare);

Sa më sipër në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile, përbaruesi gjyqësor me shkresën Nr. 164, 167 Regj. Nr. 1804 Prot. datë 26.10.2021 "Urdhër për vënien e sekuestros konservative", ka urdhëruar ndër të tjera Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë, për kryerjen e veprimit ligjor si më poshtë:

- Vendosjen e masës së sekuestros konservative në % e kuotave që dorëzanësi (debitor), **Luan Bilal Manjani i dtl 08.05.1959 zotëron tek Shoqëria "Lubima" sh.p.k me NIPT K96419401J dhe Shoqëria "New Pellet" sh.p.k. me NIPT L77422401C**, bazuar mbi vlerën e detyrimit dhe kapitalit themeltar që cdo kuotë përfaqëson. Regjistrimin pranë jush dhe moskryerjen e asnjë lloji veprimi tjetër, i cili mund të sjellë ndryshimin e të dhënave të regjistrimit tregtar;

Nga verifikimi i ekstrakteve përkatëse të shoqërive në QKB, rezulton se ky veprim nuk është kryer për sa i përket urdhërimeve që lidhen me shoqërinë "Lubima" sh.p.k dhe nga ana e institucionit që ju drejtoni nuk është kthyer përgjigje.

Në këto kushte po ju drejtohem sërish duke ju Njoftuar për kryerjen e veprimeve përkatëse dhe njoftimin e përbaruesit gjyqësor mbi veprimet që do të ndërmerren.

Për personat që bëhen pengesë do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe cdo veprim apo mosveprim që do të kryhet në kundërshtim me këtë urdhër do të sjellë përgjegjësi penale për personat përgjegjës sipas nenit 320 të Kodit Penal.

Bashkëlidhur: Shkresë Nr. 164, 167 Regj. Nr. 1804 Prot. datë 26.10.2021 "Urdhër për vënien e sekuestros konservative".

"Zyrë e Përbarimit Privat Tirana Bailiff's" sh.p.k.
PËRMBARUES GJYQËSOR

NATASHA LASKA



"Zyrë e Përbarimit Privat Tirana Bailiff's" Sh.p.k. Adresa: Bll. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 13, Tirane, Tel: +355 672082134, nlaska@bailiff.al NIPT L82208022H, NR. LICENSA LN-5984-10-2018.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

164, 167 Regj.
Nr. 1804 Prot.

Tiranë më 26.10.2021

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT TIRANË

Për dijeni: Shoqëria "Lubima" sh.p.k. me NIPT K96419401J, administrator Luan Manjani.

Për dijeni: Shoqëria "New Pellet" sh.p.k. me NIPT L77422401C, administrator Shkëlqim Keshi.

Për dijeni: Luan Bilal Manjani i dtl 08.05.1959.

Për dijeni: Zare Bilal Keshi e dtl 28.05.1949.

Për dijeni: "Raiffeisen Bank" sh.a.;

Unë Natasha Laska, në cilësinë e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë "Zyrës së Përmbarimit Privat Tirana Bailiff's" sh.p.k., në referim të Vendimit për Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 2847 Akti datë 06.05.2021 dhe Vendimit Mbi lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit nr. 7602 datë 19.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këto Urdhra, duke regjistruar në dosjet përmbarimore Nr. 164, 167 Regj. kërkesën e kreditorit, lidhur me Titujt Ekzekutivë, Kontratë Kredie me Kufi Nr. 576 Rep., Nr. 210 Kol. datë 22.05.2018, e ndryshuar, Kontratë Kredie bankare Nr. 575 Rep., Nr. 209/2 Kol. datë 22.05.2018 me palë dhe objekt:

Kreditor: "Raiffeisen Bank" sh.a.;

Debitor: Shoqëria "New Pellet" sh.p.k. me NIPT L77422401C;

Debitor; Barrëdhënësit: Shoqëria "Lubima" sh.p.k. me NIPT K96419401J;

Dorëzanës: Shkëlqim Nexhat Keshi i dtl 25.07.1974

Dorëzanës: Luan Bilal Manjani i dtl 08.05.1959;

Hipotekues: Zare Bilal Keshi e dtl 28.05.1949,

Objekt: Kthim Shume (kredi bankare);

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 1564 Prot. datë 21.06.2021, dhe Nr. 1654 prot. datë 13.08.2021 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmbajnë Urdhrat e Ekzekutimit Nr. 2847 Akti datë 06.05.2021 dhe Nr. 7602 Akti datë 19.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA SE:

Debitorët Shoqëria "Lubima" sh.p.k., Shoqëria "New Pellet" sh.p.k. dhe Dorëzanësit, Z. Luan Bilal Manjani, Shkëlqim Nexhat Keshi janë lajmëruar të shlyejnë vullnetarisht detyrimin e marrë përsipër ndaj kreditorit "Raiffeisen Bank" sh.a., brenda 10 ditëve pas të cilave do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm. Debitorët dhe dorëzanësit e mësipërm kanë marrë njoftim në datën 23.06.2021 dhe 17.08.2021, të konfirmuara me letërporosi.

Në këto kushte në referim të nenit 519 të K.Pr.Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm me vendimin Nr. 164 Regj. Nr. 1583 Prot. datë 06.07.2021 dhe vendimin Nr. 167 Regj. Nr. 1676 Prot. datë 30.08.2021. Dhe si rrjedhojë në referim të nenit 527 e në vijim të të K.Pr.Civile duhet vënë sekuestër mbi pjesët/kuotat që dorëzanësit Shkëlqim Keshi dhe Luan Manjani, zotërojnë tek Shoqëria "Lubima" sh.p.k. dhe Shoqëria "New Pellet" sh.p.k., në masën që do të jetë e nevojshme, për plotësimin e detyrimit në vlerën 249,117.22 Euro plus 35,231,290.75 lekë si dhe kamatat ligjore, sipas nenit 5 të Ligjit 48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" plus tarifën fikse të shërbimit përmbarimor gjyqësor në shumën prej 3,141,801.2 lekë me Tvsh, sipas Udhëzimit Nr.385/7 datë 28.06.2017 të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Për sa më sipër bazuar në nenin 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

1. Vendosijen e masës së sekuestros konservative në % e kuotave që dorëzanësi (debitor), **Luan Bilal Manjani i dtl. 08.05.1959 zotëron tek Shoqëria "Lubima" sh.p.k me NIPT K96419401J dhe Shoqëria "New Pellet" sh.p.k. me NIPT L77422401C**, bazuar mbi vlerën e detyrimit sipërcituar dhe kapitalit themeltar që cdo kuotë përfaqëson. Regjistrimin pranë jush dhe moskryerjen e asnjë lloj veprimi tjetër, i cili mund të sjellë ndryshimin e të dhënave të regjistrit tregtar;




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

2. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në % e kuotave që dorëzanësi (debitor) **Shkëlqim Nexhat Keshi** i dtl. **25.07.1974**, zotëron tek Shoqëria “New Pellet” sh.p.k. me NIPT **L77422401C**, bazuar mbi vlerën e detyrimit sipërcituar dhe kapitalit themeltar që cdo kuotë përfaqëson. Regjistrimin pranë jush dhe moskryerjen e asnjë lloj veprimi tjetër, i cili mund të sjellë ndryshimin e të dhënave të regjistrit tregtar;
3. Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me vendosjen e masës së sekuestros konservative në pjesët/kuotat që dorëzanësit **Luan Bilal Manjani** i dtl. **08.05.1959** dhe **Shkëlqim Nexhat Keshi** i dtl. **25.07.1974** zotërojnë në shoqëri të tjera të regjistruara pranë jush;
4. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni, pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri, lidhur me debitorët e sipërpërmendur të njoftohemi në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana juaj;
5. Nga casti i vënies së sekuestros, debitori nuk ka të drejtë të disponojnë mbi kuotat deri në një urdhër të dytë të Përmbaruesit Gjyqësor, në të kundërt do të mbahet përgjegjësi, sipas dispozitave të Kodit Penal;
6. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe cdo veprim apo mosveprim që do të kryhet në kundërshtim me këtë urdhër do të sjellë përgjegjësi penale për personat përgjegjës sipas nenit 320 të Kodit Penal;
7. Ky urdhër u njoftohet palëve, të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, brenda 5 ditëve nga marrja dijani.

“Zyrë e Përmbarimit Privat Tirana Bailiff’s” sh.p.k.

PËRMBARUES GJYQËSOR
NATASHA LASKA



TIRANA
21 OCT 2021
KABINETI I MARRES

63

LETET E POROSITUR

PERMBAN Letet lajmerimin Nr. 164, 167 Regi. Nr. 1804 — Prot. Dt. 26 / 10 / 2021.

Dërguar nga: "Zyrë e Përbarimit Privat Tirana Bailiff's" sh.p.k.
Adresa: Bly Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, 2, kati 13, Tiranë

Drejtuar Adresa: Qendrës Kombëtare të Biznesit (Q.K.B)
TIRANË

Letet e porositur me te cilen vertetohet se lajmerimi i mesiperm eshte komunikuar ne date. 2021

Postieri

Besmir Shulku



Marresi

Fabrizio Kushi

28/10

